



Hapet thirrja për praktika profesionale me finalizim punësimi, të ofruara nga Kompania Sews Cabind Albania

Në kuadër të bashkëpunimit midis Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Kompanisë Sews Cabind Albania, hapet thirrja për praktika profesionale me finalizim punësimi, pranë Kompanisë Sews Cabind Albania, për studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike.

Profili i Kompanisë:

Sews Cabind Albania është pjesë e Sumitomo Electric Industries Group, një nga kompanitë më të mëdha industriale dhe financiare në botë.

Me seli në Collegno, Torino, Itali dhe me pesë impiante prodhimi midis Marokut dhe Polonisë, Sews Cabind është një partner global në furnizimin e sistemeve të kabllave elektrike dhe komponentëve për sektorin e automobilave.

Sews-Cabind ka vendosur të investojë në Shqipëri, duke pasur plane ambicioze zhvillimi për të ardhmen dhe si rezultat i këtyre planeve të zhvillimit, aktualisht është duke kërkuar kandidatë potencialë për pozicionet e mëposhtme:

- **Pesë inxhinierë elektrik, në Departamentin Teknik**

Oferta e praktikës:

- Praktikë profesionale me finalizim punësimi;
- Mundësi zhvillimi profesional;
- Kushte të qëndrueshme të praktikës;
- Trajnime të brendshme për përmirësimin e aftësive teknike.

Kërkesat që duhet të plotësojnë kandidatët:

- Arsimi i Lartë, pranë Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike (Preferohen kandidatë me Master);
- Praktikë me kohë të plotë (40 orë në javë), ose me kohë të pjeshme (20 orë në javë);
- Aftësi për projektim në Autocad dhe aftësi të mira teknike;
- Aftësi të punës në grup;
- Kërkohej korrektësi dhe përpikmëri.

Të interesuarit të dërgojnë CV-në në adresën e mëposhtme:

Sews-Cabind Albania shpk, rruga "Erzeni", Bathore, Kamëz.

e-mail: rekrutime@sews-cabind.it

Telefon : +355 42 481601

Kompania do të kontaktojë vetëm me kandidatët e përzgjedhur.

Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të rreptë, sipas Ligjit nr.9887, "Për mbrojtjen e të dhënave personale".



Për informacione shtesë, mund të kontaktoni me sektorin e koordinimit dhe partneritetit në UPT, me email: rkodra@upt.al
